



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore duke u bazuar në nenin 67, 68 dhe 69 paragrafi 2 të Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 2 paragrafi 2.2 të Statutit të Komunës së Gjakovës, shpall:

KONKURS PËR PRANIM

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar

Emri i grupit:	Specialistë të Përgjithshëm të Shëndetit/Mjekësisë
Institucioni:	Komuna e Gjakovës
Njësia:	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
Lloji i pozitave:	Nëpunës i Shërbimit Publik
Data e njoftimit:	21.01.2022
Afati për aplikim:	21.02.2022 – 07.03.2022
Numri i referencës:	01-111/01-1506
Kohëzgjatja e emërimit:	E pacaktuar

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

- a. Ofron shërbime me standard të lartë bazuar në mjekësinë e bazuar në dëshmi;
- b. Ofron shërbime gjithëpërfshirëse për individin/pacientin dhe familjen në të gjitha episodet e jetës nën mbikëqyrje të Mjekut Familjar;
- c. Harton dhe zhvillon planin e trajtimit të sëmundjes dhe trajton pacientin si figurë qendrore nën mbikëqyrje të Mjekut Familjar;
- d. Përcakton diagnozë diferenciale dhe diagnozën e punës në përputhje me simptomatologjinë;
- e. Përcjellja sistematike e rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve dhe adoleshentëve;
- f. Kujdesi për personat e moshuar në nevojë;
- g. Ofron kujdes për rastet urgjente dhe i referon rastet me kohë dhe në mënyrë adekuate;
- h. Interpretin rezultatet e testeve të shpejta laboratorike;
- i. Komunikon ose konsultohet me specialist të mjekësisë familjare sipas nevojës;
- j. Referon pacientin te specialist i mjekësisë familjare dhe për kujdes spitalor;
- k. Kujdesi i vazhdueshëm për pacientët me sëmundje kronike jo ngjitëse;
- l. Kontrolli i sëmundjeve ngjitëse (hulumtimet epidemiologjike);
- m. Promovimi shëndetësor dhe parandalimi i sëmundjeve si dhe shërbimet në komunitete (grupet vulnerable, vendet rurale, shkolla, komunitete);
- n. Zbatimi i programit të vaksinimit, edukimi shëndetësor, etj.;
- o. Inkurajohet nga puna ekipore (mjeku familjar, infermieret familjare, infermieret në komunitet);
- p. Vlerëson efektivitetin e kujdesit të ofruar nga ekipi i mjekësisë familjare, identifikon problemet dhe kërkon nga anëtarët e ekipit zgjidhjen e tyre;
- q. Përcaktohet nga mjeku familjar si pjesë e ekipit të mjekësisë familjare në përputhje me nevojat e pacientit aftësitë dhe kualifikimet për të përmbushur nevojat e institucionit;
- r. Merr pjesë në trajnime, vlerësim të kompetencave orientim dhe edukim;
- s. Komunikon qartë saktë dhe krijon klimë të mirë për punë që rritë kënaqshmëritë në punë;

- t. Kryen edhe punë administrative, vepron në mënyrë profesionale, duke respektuar rregulloret për KPSH dhe vepron në përputhje me të gjitha rregulloret, procedurat dhe politikat e MSH në fuqi;
- u. Përcakton diagnozën përfundimtare dhe përshkruan terapinë;
- v. Nënshtrohet programit nacional të zhvillimit të vazhdueshëm profesional;
- w. Përkujdeset për konfidencialitetin e individit;
- x. Përcjellja e sëmundshmërisë nën mbikëqyrje të mjekut familjar;
- y. Identifikimi i grupeve të veçanta të rrezikut;
- z. Merr pjesë në grupet e rishqyrtimit kolegjial dhe sjell vendime të përbashkëta për menaxhimin e sëmundjeve;
- aa. Ndhmon mjekun familjar në zhvillimin e auditeve mjekësore në institucionin përkatës;
- bb. Merr pjesë në takime, konferenca dhe tregon interesim në zhvillimin e strategjive për përmirësim të intervenimeve klinike dhe nivelit të lartë të kujdesit ndaj pacientit;
- cc. Tregon aftësi për zbatim të vazhdueshëm të detyrave të punës sipas PVP.

2. Kërkesat e përgjithshme për pranim:

- a. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- b. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c. Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- d. Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- e. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- f. Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

3. Kërkesat e përgjithshme formale:

- a. Arsimimi i kërkuar: Diplomë të studimeve universitare në **Fakultetin e Mjekësisë, dega Mjekësi e Përgjithshme**.
- b. Përvoja e punës e kërkuar: **Nuk kërkohet**.

4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme:

- a. Të jetë i regjistruar dhe licencuar në MSH;
- b. Të ketë ndjenjë përgjegjësie, i përkushtuar ndaj profesionit dhe ndryshimeve të ketë shkathtësi pune të pavarur dhe në ekip si dhe shkathtësi të mira komunikimi;
- c. Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit);
- d. Të ketë gatishmëri të punojë me të gjitha grupet, pa dallim moshe, gjinie, kulture, etnie, religjioni apo race.

5. Pozitat aktualisht të lira:

Nr.	Titulli i pozitës	Koeficienti	Vendi i punës
1.	Mjek i Përgjithshëm	7.2	QKMF dhe QMF

6. Mënyra e aplikimit:

Aplikacionet merren në *Qendrën e Informimit*, kati përdhese në ndërtesën e Komunës së Gjakovës si dhe mund të shkarkohet nga ueb faqja e Komunës së Gjakovës, dhe i plotësuar dorëzohet personalisht në *Zyrën e Pranimit* apo të dërgohen me postë në këtë adresë: *Komuna e Gjakovës, Rruga "UÇK" numër 53, 50000 Gjakovë, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Kati III.*

7. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim:

- a. Formulari i aplikimit, i plotësuar;
- b. Rezymeja personale (CV);
- c. Kopjet e dokumentit personal (*letërnjoftim ose pasaportë*);
- d. Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore (*personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë diplomat e nostrifikuara nga Ministria e Arsimit*);
- e. Kopjet e dëshmisë së punësimit;
- f. Kopjet e dëshmisë së trajnimeve;
- g. Kopjen e licencës;
- h. Dokumenti që nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë (*lëshuar nga Gjykata Themelore*);
- i. Certifikata e Mjekut pas përzgjedhjes nga komisioni.

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

- a. Testimi me shkrim
- b. Intervistë

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët dhe shpallja e rezultateve përfundimtare:

Përmes ueb faqes së Komunës së Gjakovës (<https://kk.rks-gov.net/gjakove/>) dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>).

10. Sqarime shtesë:

- a. Dokumentet duhet të jenë në kopje sepse ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.
- b. Informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).
- c. Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.